



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1081/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi e studimit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *E Drejta Civile dhe Biznesore LLM 60 ECTS, me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;*
- II. Riakreditohen programi i studimit i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 1. *Menaxhim Mjedisi MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
 2. *Menaxhim i Burimeve Njerëzore MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I dhe II, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimet e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I dhe II mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me bartësit e programeve si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>E Drejta Civile dhe Biznesore LLM 60 ECTS</i>	Berat Aqifi
2.	<i>Menaxhim Mjedisi MSc 120 ECTS,</i>	Mimoza Hyseni Spahiu Albona Shala Abazi
3.	<i>Menaxhim i Burimeve Njerëzore MSc 120 ECTS,</i>	Theranda Beqiri Mersiha Kacamakovic

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *E Drejta Civile dhe Biznesore LLM 60 ECTS*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Bertel De Groot, Dunja Duic dhe Marko Komso është organizuar më 11.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht pesë (5) fusha.
2. Për programin e studimit; *Menaxhim Mjedisi MSc 120 ECTS*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Domagoj Svigir dhe Marija Vasilevska, është organizuar më 19.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha.
3. Për programin e studimit; *Menaxhim i Burimeve Njerëzore MSc 120 ECTS*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: "Marina Gregoric, Sanja Kalambura, Domagoj Svigir dhe Marija Vasilevska, është organizuar më 19.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të, të mbajtur më datë 20.05.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

